



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 10-111-01-28099-25

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date

OBILIQ - OBILIČ - OBILIC



**Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republik of Kosova
Komuna e Obiliqit/Opština Obilic/Municipality of Obiliq**

Bazuar në nenet 6,8 dhe 18 të Rregullores Për Ndarjen E Bursave, Kompensimin E Shpenzimeve Të Udhëtimit Dhe Aktivitet Jashtëshkollorë, Nr.-I-104, të datës 31.08.2020, dhe kërkesën me nr.-10-104-02-28089, të datës 19.09.2025, Drejtoria e Arsimit më 19.09.2025 shpall:

KONKURS

**Për bursa të nxënësve për shkollat e mesme të larta të Komunës së Obiliqit
për vitin shkollor 2024-2025**

Kushtet:

- Të jenë banorë të Komunës së Obiliqit.
- Të jenë të regjistruar si nxënës për herë të parë në vitin shkollor për të cilin ndahet bursa.

1.Kriteret për të fituar bursën për nxënës të shkollave të mesme të larta janë:

- 1.1 Të jenë nxënës të rregullt dhe të vijojnë mësimin rregullisht, në shkollat e mesme të larta të Komunës së Obiliqit;
- 1.2 Për nxënës të Gjymnazit "17 Shkurti" në Obiliq , të kenë të përfunduar klasën paraprake të shkollës së mesme të lartë me sukses të shkëlqyeshëm (përfshihet klasa e X-të);
- 1.3 Për nxënës të SHMLP "Ismail Dumoshi" në Obiliq , të kenë të përfunduar klasën paraprake, me sukses të shkëlqyeshëm (bursa ndahet edhe për klasën e X-të) ;
- 1.4 Për nxënës me nevoja të veçanta, fëmijë të dëshmorëve, nxënës familjet e të cilëve janë raste sociale, dhe nxënësit jetimë (që nuk kanë asnjërin prind ose kanë vetëm njërin prind) të kenë të përfunduar klasën paraprake me sukses të shkëlqyeshëm (bursa ndahet edhe për klasën e X-të).

Dokumentet e kërkuara:

- Vërtetimin nga shkolla se janë regjistruar nxënës të rregullt në vitin shkollor 2024-2025
- Të kenë të përfunduar klasën paraprake me sukses të shkëlqyeshëm (dëftesat)
- Vërtetimin nga shkolla se nuk janë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër
- Dëshmi mbi gjendjen ekonomike-sociale
- Letërnjoftimi ose Certifikatën e lindjes
- Konfirmimi bankar i nxënësit ose i njërit prind
- Letërnjoftimi i nxënësit ose i njërit prind

Sqarim:Letërnjoftimi dhe konfirmimi i bankës duhet të jenë vetëm të njërit prind

Fletëkërkesat merren në Zyrën e pranimi të KK-së ,ose në faqe zyrtare të komunës dhe dorëzohen me dokumente të kompletuara në të njëjtën Zyrë. Afati i konkurrit është 15 ditë pune.

Drejtori :Fitore Hashani

